



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 6.7.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datave 4 dhe 6 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të mbrojtur projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, Ministri dhe Zëvendësministri i Financave, si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Projektligji është pjesë e paketës fiskale që po shqyrtohet aktualisht në Komision, e cila parashikon disa masa lehtësuese në fushat e tatimit mbi të ardhurat, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe taksave vendore.

Përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit është lehtësimi i veprimtarisë së agroturizmit. Veprimtaria e agroturizmit, si veprimtari pritëse që zhvillohet në një fermë apo njësi tjetër agrikullore, ka qëllim të tërheqë vizitorë, duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse. Kjo veprimtari ka qëllim mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e traditave dhe promovimin e produkteve tipike të zonës, duke mbështetur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në zonat rurale.

Projektligji parashikon reduktimin nga 20 për qind, në 6 për qind, të normës së tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, të ofruar brenda strukturave në

të cilat zhvillohet veprimtari pritëse, e çertifikuar si agroturizëm. Kjo normë e reduktuar nuk ofrohet për furnizimin e pijeve, të ofruara nga këto struktura.

Norma e reduktuar e TVSH-së ofrohet për personat e regjistruar vetëm për zhvillimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe jo për personat që krahas kësaj veprimtarie, ushtrojnë edhe veprimtari të tjera ekonomike. Kjo kërkesë është vendosur për të identifikuar saktë të ardhurat nga veprimtaria, punësimin, riskun tatimor dhe tregues të tjerë, në mënyrë që të ketë një transparencë dhe kontroll të plotë të kësaj veprimtarie dhe administrim eficient tatimor.

Efektet e normës së reduktuar fillojnë në vitin pasardhës pas përfitimit të statusit “subjekt i çertifikuar agroturizmi”.

Nevoja për hartimin e projektligjit.

Së pari, hartimi i këtij projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi ai synon të krijojë lehtësi fiskale dhe të nxisë zhvillimin e agroturizmit në vendin tonë. Zhvillimi i sektorit të turizmit në përgjithësi dhe i sektorit të agroturizmit, si pjesë përbërëse e tij, ka qenë dhe vijon të jetë një ndër prioritetet e ekonomisë sonë.

- *Programi i Qeverisë* e ka përcaktuar zhvillimin e agroturizmit si prioritet, për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm të zonave rurale.
- *Strategjia Ndërsektorale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2014-2020* ka përcaktuar se agroturizmi është një ndër mjetet e promovimit turistik, zhvillimit ekonomik, rritjes së qëndrueshmërisë së turizmit, si dhe ruajtjes e promovimit të identitetit kulturor e lokal.
- *Strategjia për Zhvillimin e Zonave Rurale 2018-2020* ka parashikuar hartimin dhe zbatimin e një programi për përmirësimin e potencialit turistik në zonat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural. Programi parashikon ndërhyrjen me financime në 100 fshatra, ku ndër të tjera do të mbështetet me instrumente financiare dhe fiskale krijimi i një rrjeti fermash agroturistike, për të siguruar zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit rural.

Së dyti, ligji për TVSH ka parashikuar reduktimin e normës së TVSH, në nivelin 6 për qind, në strukturat akomoduese të fushës së turizmit. Por, në ligjin për turizmin agroturizmi nuk klasifikohet si strukturë akomoduese, prandaj nuk mund të aplikohet shkallë e reduktuar e TVSH për këtë sektor. Për këtë arsye, u paraqit nevoja për të hartuar një projektligj të ri për vendosjen e normës së reduktuar të TVSH në këtë sektor.

Baza ligjore për përjashtimin nga TVSH.

E drejta e përjashtimit nga TVSH buron nga neni 49 i ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, i cili parashikon që përveç shkallës standarde, mund të aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH. Dhënia e së drejtës së përjashtimit nga TVSH bazohet në nenin 98 të Direktivës së Parlamentit Europian dhe Këshillit 2006/112/KE, me të cilën është përafruar ky ligj. Në aneksin 3 të Direktivës përcaktohen furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, mbi të cilat aplikohen normat e reduktuara të TVSH.

Përfitime të tjera për agroturizmin.

Sektori i agroturizmit, krahas reduktimit të normës së TVSH nga 20 për qind në 6 për qind për shërbimet e akomodimit dhe restorantit, do të ketë edhe disa përfitime të tjera nga paketa fiskale që po shqyrtohet aktualisht, siç janë reduktimi i tatimit mbi fitimin nga 15 për qind në 5 për qind, si dhe përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja në fushën e agroturizmit.

Vlerësimi për projektligjin.

Projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi krijon lehtësi fiskale në sektorin e agroturizmit, duke ndikuar në nxitjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve lokale, si dhe zgjerimin e veprimtarisë së biznesit, i cili pritet të ofrojë akomodim, ushqim, çlodhje, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën ose njësinë agrikulturore.

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe me disa vende të BE, vendi ynë me këtë projektligj ofron një ndër normat më të ulëta të TVSH për strukturat e agroturizmit.

Gjatë diskutimit Komisioni rekomandoi që përkufizimi për termin “pije” të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjithashtu në Komision pati diskutime lidhur me përfshirjen në skemën e reduktuar edhe të pijeve të prodhuara nga struktura pritëse dhe që tregtohen brenda shërbimit të restorantit të kësaj strukture.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje, me një ndryshim, si më poshtë:

Në nenin 1, pika 5 të riformulohet si më poshtë:

“5. Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si “agroturizëm”.

RELATORJA

Evis KUSHI

KRYETARI

Erion BRAÇE